

## Vendim nr. 317 datë 26.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 26.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **ILIRJAN NGJELA, BESNIKE HASA (NGJELA)**, përfaqësuar nga avokate Marjana Velçani, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i kërkesës “Për pushimin e çështjes penale nr. 593, viti 2021” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan) dhe i vendimeve nr. 2084/630 (13-2022-303), datë 27.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan); nr. 10-2022-824 (162), datë 04.05.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës (sot Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë); nr. 00-2022-1309, datë 27.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 4, 17, 18, pika 1, 32, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pika 1, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577,**

**datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës  
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.  
8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit Agim Ngjela (vëllai i tyre), i cili ka humbur jetën në një aksident automobilistik të ndodhur në datën 25.04.2021. Për këtë ngjarje Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. 593, datë 19.05.2021 ndaj drejtuesit të automjetit për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal (*KP*).

2. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 26.11.2021 prokuroria ka njoftuar se çështja penale duhet të pushohet, pasi ekzistonin rrethanat e parashikuara nga neni 328, pika 1, shkronja “b”, i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), në kushtet kur mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet si vepër penale, fakti nuk përbën vepër penale dhe nuk ka elemente të ndonjë veprë tjetër penale. Në vijim, prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2084/630 (13-2022-303), datë 27.01.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se mungojnë elementet e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 290/3 i KP-së, ndaj fakti nuk përbën dhe nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për këtë shkak procedimi penal nuk mund të vazhdojë.

4. Mbi ankimin e ushtruar, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-824 (162), datë 04.05.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se shkak u përcaktues në ardhjen e pasojës kanë qenë veprimet e viktimës në rrugë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1309, datë 27.10.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të

parashikuara në nenin 432 të KPP-së, ndërsa pretendimet që lidhen me vlerësimin e fakteve dhe provave nuk i përkasin juridiksionit të tij.

6. Në datën 11.11.2024 kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve, sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar me aktet e kërkuara në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.11.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuessve

7. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se gjykatat u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 7.1. *Të drejtën për t'u njoftuar*, pasi as prokuroria, as gjykatat nuk i kanë njoftuar për procesin gjyqësor duke qenë viktimat e procesit. Njëri nga kërkuessit jeton prej shumë vitesh jashtë vendit dhe avokati i tij asnjëherë nuk e ka vënë në dijeni për hapat e procesit e, aq më tepër, për vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili është marrë në dhomën e këshillimit, kurse kërkuessja tjetër nuk është njoftuar fare. Kërkuessit janë njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 18.10.2024, sipas shënimit të kryesekretarisë së asaj gjykate dhe ndonëse ajo gjykatë është shprehur në procesverbalin e datës 27.10.2022 se palët kanë marrë dijeni rregullisht për procesin, në fakt është njoftuar vetëm avokati i njërit prej tyre dhe jo ata.
- 7.2. *Të drejtën për t'u dëgjuar*, pasi mungesa e njoftimit ka sjellë edhe pamundësinë që ata të shpreheshin për cilësinë e provave të marra në gjykim dhe rrethanat në të cilat ato janë marrë.
- 7.3. *Të drejtën për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë në mënyrë empirike në dhomën e këshillimit ka vendosur të mos pranojë rekursin e tyre, duke dhënë një vendim abuziv. Mospërmendja nga gjykata e shkallës së parë e emrit të kërkuesses Besnike Ngjela dhe arsyetimi nga gjykata e apelit për panevojën e njoftimit të të gjithë trashëgimtarëve të të ndjerit është absurd, duke e bërë parashikimin e nenit 58 të KPP-së “Të drejtat e viktimës së veprës penale” të panevojshëm.
- 7.4. *Të drejtën e aksesit*, pasi procesi gjyqësor është zhvilluar pa praninë e tyre, gjë e cila përbën shkelje të rëndë procedurale, e cila nuk është rregulluar as nga Gjykata e Lartë. Atyre nuk u janë garantuar të drejtat që lidhen me njohjen e akteve dhe për vënien në lëvizje të gjykatës me kërkesa procedurale.

- 7.5. *Të drejtën për gjykim të drejtë*, pasi palët nuk janë thirrur në proces, nuk kanë dhënë deponimet e tyre, nuk janë marrë parasysh kërkesat e tyre dhe nuk janë pyetur dëshmitarët. Për shkak të mosnjohimit ata nuk kanë pasur mundësi të paraqesin gjatë gjyqimit aktin e ekspertimit të përgatitur privatisht.
- 7.6. *Parimin e paanësisë*, pasi çështja është përmbledhur vetëm në dorën e prokurorit dhe vendimet gjyqësore janë dhënë në funksion të vendimit të marrë nga prokurori në shkelje të plotë të së vërtetës. Ndërsa gjyqtari i gjykatës së apelit nëpërmjet arsyesimit të vendimit të tij ka marrë rolin e ekspertit, ndërkohë që nuk është kjo detyra e tij.
- 7.7. *Parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, për shkak se ata nuk janë njoftuar për procesin dhe nuk u është dhënë mundësia për t'u mbrojtur dhe për të kundërshtuar vërtetësinë e provave që ka paraqitur prokuroria.
- 7.8. *Standardin e arsyesimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje shkaqeve me natyrë ligjore dhe kushtetuese të ngritura nga kërkuessit, viktimat të procesit. Gjykata e Lartë e ka trajtuar çështjen në mënyrë sipërfaqësore, ndërkohë që ka pasur shkelje të rënda të dispozitave ligjore dhe procedurale nga gjykatat më të ulëta, me pasojë pavlefshmërinë e vendimeve, pavlefshmërinë absolute të akteve dhe/ose papërdorshmërinë e provave.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuessve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarat në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen

njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor për të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

10. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve penale të cilat kanë vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal, të përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë. Rrjedhimisht, ata e kanë plotësuar edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

11. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim Gjykata ka vlerësuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor fillimisht është vënë në lëvizje me kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal dhe pas vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për pranimin e kërkesës, kanë qenë vetë kërkuesit, të përfaqësuar me avokatin e zgjedhur, që kanë vënë në lëvizje përmes ankimit dhe rekursit gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se kërkuesit kanë pasur interes për të ndjekur fatin e çështjes, përfshirë edhe vendimmarrjen përfundimtare të Gjykatës së Lartë. Konkretisht, procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1309, datë 27.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 11.11.2024, pas më shumë se 2 vjetësh. Në përmbajtje të ankimit kushtetues kërkuesit kanë pretenduar se ata nuk janë njoftuar nga avokati i tyre për ecurinë e procesit, i cili nuk u është përgjigjur as në telefon. Njëri prej kërkuesve jeton jashtë vendit dhe vjen rrallë në Shqipëri. Ai ka marrë dijeni për vendimin pasi është interesuar personalisht në datën 18.10.2024, gjatë kohës që ka qenë në Shqipëri, duke paraqitur si provë biletat e udhëtimit me avion. Ndërsa kërkuesja tjetër nuk është njoftuar nga gjykata. Po sipas kërkuesve, ndërsa Gjykata e Lartë për vendimin e saj ka

njoftuar prokurorinë me shkresën e datës 02.02.2023, ajo nuk ka kryer të njëjtën gjë edhe për kërkuesit. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka informuar në rrugë elektronike se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 07.12.2022, e cila konsiderohet si data në të cilën kërkuesit kanë marrë dijeni efektivisht për të. Thënë kjo, data nga e cila fillon afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, në rastin konkret, është 07.12.2022.

13. Për sa më lart dhe duke u bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Kolegji çmon se kërkuesit prezumohen të kenë marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë ditën e publikimit të vendimit, më 07.12.2022. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual nuk konstatohet ndonjë rrethanë faktike e cila të dëshmojë mosmarrjen dijeni të vendimit për arsye objektive. Për më tepër, argumenti i kërkuesve që ka të bëjë me problematikat në komunikimin me avokatin e zgjedhur apo faktin se njëri prej tyre nuk jeton në Shqipëri, nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të justifikuar paraqitjen e ankimit kushtetues rreth 1 vit e 11 muaj pas publikimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Po kështu, edhe argumenti se sipas shënimit të kryesekretarisë ata janë njohur me vendimin në datën 18.10.2024 nuk përbën argument të mjaftueshëm, në kushtet kur një shënim i tillë nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht, pasi mund të vendoset në çdo kohë dhe me kërkesë të kujtqo që paraqitet në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër, nuk rezulton që kërkuesit apo përfaqësuesi ligjor të kenë lënë adresat elektronike me qëllim kryerjen e komunikimit edhe në këtë formë. Ndaj, në këtë aspekt, argumentet e tyre nuk mund të rrëzojnë prezumimin për datën e marrjes dijeni të vendimit.

14. Parë nën këtë analizë, Kolegji vë në dukje se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuesve, nga i cili ka filluar afati 4-mujor, konsiderohet data 07.12.2022, kur vendimi është publikuar i arsyetuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe është bërë i disponueshëm për kërkuesit. Duke iu referuar kësaj date, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.